



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 07.03.2025

Numër Protokolli: 2364/2025

A.nr159/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.159/2025, të datës 22.01.2025, të parashtruar nga ankuesi G.D, kundër organit të punësimit: Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridiko-administrative “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi, 1 nën paragrafi, 1.1, nenin, 16 paragrafi, 3 dhe nenin, 18 paragrafi, 1 nën paragrafin, 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.159/2025, e datës 22.01.2025 e parashtruar nga ankuesi G.D, ashtu që, ***anulohet*** Lista me numër protokolli 509, e datës 20.12.2024, për shpalljen e rezultateve përfundimtare (testim me shkrim dhe intervistës më gojë), si dhe çdo veprim tjetër administrativ i ndërmarr në fazën e vlerësimit, lidhur me konkursin e brendshëm për gradën Mbikëqyrës i Lartë në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan/Shërbimi Korrektues i Kosovës, ***ndërsa, çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në fazën e vlerësimit profesional.***

II. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të vendimit, të themeloj Komisionin e ri të Gradimit, në pajtim me Udhëzimin Administrativ MD-Nr.07/2024 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, ndërsa, ky i fundit obligohet të zhvilloj procedurën e vlerësimit profesional të kandidateve në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Ankuesi G.D (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 18.01.2025, përmes emailit ankesa.kpmschk@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 22.01.2025, kundër listës së rezultateve përfundimtare me numër protokollit 509, të datës 20.12.2024, të publikuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, lidhur me konkursin e brendshëm për gradën Mbikëqyrës i Lartë në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.01.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues të Kosovës. Ndërsa, Këshilli më datë 24.01.2025 ka pranuar nga Shërbimi Korrektues të Kosovës përgjigjen në ankesë së bashku me provat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 427/2025 të datës 22.01.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së; Konkursin e Brendshëm i datës 19.08.2024; Listën e rezultateve përfundimtare e datës 20.12.2024; Komunikimet nga data 18.01.2025 mes ankuesit dhe ankesa.kpmschk@rks-gov.net; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 23.01.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 24.01.2025; Listën e rezultateve të intervistë me gojë datës 19.12.2024; Vendimin me numër protokollit 991 i datës 21.10.2024 për emërimin e komisionit vlerësuar dhe akt emërimet/kontratat e anëtarëve të komisionit; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë; Listën e aplikantëve; Listën e ngushtë datës 14.11.2024; Kërkesën për punësim e datës 05.09.2024 e ankuesit me dokumentacionet nga faqe 1-40; Kërkesën për punësim të datës 04.09.2024 të kandidati B.K me dokumentacionet nga faqe 1-32; Kërkesën për punësim të datës 06.09.2024 të kandidat P.M me dokumentacionet nga faqe 1-41.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa është e bazuar, ***sepse:***

Nga provat e lëndës rezulton se Shërbimi Korrektues i Kosovës, më datë 19.08.2024, ka shpallur konkursin e brendshëm me numër reference MD/SHKK/11-14.08.2024, për pozitën Mbikëqyrës i Lartë, në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, 2 pozita.

Tutje, sipas shkresave të lëndës del se në këtë konkurs kanë aplikuar shtatë (7) kandidatë mesin e tyre edhe ankuesi, i cili i është nënshtruar testit me shkrim dhe intervistës me gojë, ndërsa sipas listës së rezultateve përfundimtare të testit me shkrim dhe intervistë me gojë, më numër protokollit 509, të datës 20.12.2024, si kandidatë më shumë pikë të vlerësimit janë: Blerim Kadriu më 88.7 pikë, Premtim Maliqi më 80.5 pikë dhe ankuesi 78.8 pikë.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Komisioni vlerësues është themeluar në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ MD-Nr.07/2024 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues pasi që Kryesuesi dhe njëri anëtar i komisionit duhet të kenë së paku një (1) gradë më të lartë së grada për të cilën zhvillohet procedura e rekrutimit, ndërsa, anëtarë të tretë duhet të jetë nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Komisioni i vlerësimit nuk ka bërë vlerësim të drejtë në krahasim me kundër kandidatet pasi që kam dhënë përgjigje të sakta. Kërkon që procedura e rekrutimit për këtë pozitë të kthehet në procesin e formimit të komisionit të ri sipas kritereve ligjore.

Në kuptim të statusit ligjor të të punësuarve në Shërbimin Korrektues, Kolegji i Këshillit, i'u referua nenit 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët ku përcaktohet: ***“1. Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunëses/it civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarat/it e shërbimit korrektues.... 2. Rregullimi me ligj të veçantë për nëpunësen/in civil me status të veçantë, sipas paragrafit 1. të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm elementet e marrëdhënies së punës, si në vijim: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. trajnimet dhe zhvillimin profesional; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve; 2.6. përcaktimin e shkeljeve dhe masave disiplinore shtesë; 2.7. disiplinën dhe vlerësimin.*”**

Duke u bazuar në faktin së të punësuarit në Shërbimin Korrektues të Kosovës kanë statusin e nëpunësit civil me status të veçantë, Kolegji i Këshillit ju referua Udhëzimit Administrativ MD-Nr.07/2024 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues dhe si rrjedhojë konkursi i brendshëm për pozitën Mbikëqyrës i Lartë në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, është hapur në pajtim me nenit 7 të këtij udhëzimi, pasi që procedura ka të bëjë më avancimin në gradë, ndërsa kriteret për gradën Mbikëqyrës i Lartë janë të përcaktuara sipas nenit 9 të Udhëzimit Administrativ MD-Nr.07/2024 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues.

Nisur nga pretendimi ankimor së Komisioni vlerësues është themeluar në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ MD-Nr.07/2024 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, Kolegji nga analizimi i provave materiale të çështjes ka gjetur së me vendimin më numër protokolli 991 të datës 21.10.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës është emëruar komisioni përzgjedhës për procesin e gradimit për pozitën Mbikëqyrës dhe Mbikëqyrës i Lartë në përbërje: *A.K-Menaxher i Burimeve Njerëzore DP-Kryesues; P.R-Udhëheqës për Punë Juridike dhe të Përgjithshme-Anëtar dhe V.N-Koordinator për Staf në SHKK-Anëtar.*

Rrjedhimisht, duke iu referuar dispozitave të nenit 53 të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, i cili përcakton se: *1. Sistemi i gradimit për zyrtarët korrektues është në përputhje me gradat vijuese: 1.1. kadet për zyrtar korrektues; 1.2. zyrtar korrektues; 1.3. mbikëqyrës; 1.4. mbikëqyrës i Lartë; 1.5. udhëheqës i Njesisë. 2. Procedura dhe kushtet për gradim të zyrtarëve korrektues rregullohet me aktin e nxjerrë nga Ministri i Drejtësisë, ndërsa si dhe nenit 3 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ MD-Nr.07/2024 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, ku është përcaktuar: 1.Sistemi i gradimit për zyrtarët korrektues është në përputhje me gradat si në vijim: 1.1. Kadet për Zyrtar Korrektues; 1.2.*

Zyrtar Korrektues; 1.3. Mbikëqyrës; 1.4. Mbikëqyrës i Lartë; 1.5. Udhëheqës i Njesisë. Kolegji i Këshillit, erdhi në përfundimin se duke qenë së procedura e kontestuar ka të bëjë me gradim (avancim në karrierë i hapur vetëm për zyrtarë të brendshëm), atëherë, përjashtimisht Njesisë së personelit, dy anëtarët e komisionit për procesin e gradimit, duhet të jenë në pajtim me sistemin e gradave të përcaktuar me dispozitat ligjore si me sipër, e në rastin konkret nuk është respektuar ky kriter, ngase, dy anëtarët tjerë (përjashtuar Njesisë e Personel) nuk mbajnë pozitë sipas sistemit të gradave, kështu që, Kolegji vlerëson se Komisioni i themeluar sipas Vendimit me numër protokollit 991 të datës 21.10.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, nuk është në pajtim me kërkesat ligjore të nenit 11 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MD-Nr.07/2024 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, e ku përcaktohet: “2.Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë nga zyrtarët e Shërbimit Korrektues. 3.Kryesuesi dhe njëri anëtarë i Komisionit duhet të ketë së paku një (1) gradë më të lartë se grada për të cilën zhvillohet procedura e rekrutimit. Anëtari i tretë i Komisionit duhet të jetë nga Njësia e Burimeve Njerëzore”, andaj, edhe pretendimi ankimor mbi këtë bazë është ligjërisht i bazuar.

Referuar konstatimit si më sipër, gjegjësisht duke qenë së emërimi i Komisionit për Gradim nuk ka qenë në pajtim me kërkesat ligjore, atëherë në vlerësimin e Kolegjit çdo veprim administrativ i ndërmarr nga ky i fundit konsiderohet si veprim i paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe si pasojë, Kolegji mbi bazën e këtyre të gjeturave nuk ka trajtuar në kuptim të bazushmërisë pretendimin lidhur me vlerësimin e ankuesit në testin me shkrim dhe intervistën më gojë, Rrjedhimisht, mbi këto shkaqe ligjore, e duke vepruar në pajtim me nenin 18 paragrafi, 1 nën paragrafin, 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë, Kolegji vendosi që të aprovoj ankesën si të bazuar, të anuloj Listën me numër protokollit 509, të datës 20.12.2024, për shpalljen e rezultateve përfundimtare (testim me shkrim dhe intervistës më gojë), si dhe çdo veprim tjetër administrativ të ndërmarr në fazën e vlerësimit, lidhur me konkursin e brendshëm për gradën Mbikëqyrës i Lartë në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan/Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa, çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në fazën e vlerësimit profesional, duke obliguar Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të themelojë Komisionin të ri të Gradimit në pajtim me Udhëzimin Administrativ MD-Nr.07/2024 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, ndërsa, ky i fundit obligohet të zhvillojë procedurën e vlerësimit profesional të kandidatëve në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.159/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, G.D;
- Organit të punësimit: Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.